

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Ngjarja e rëndë - Vrasja në Itali, shqiptari nuk kishte vjedhur asgjë, autori: Ndihej i dëshpëruar
ADRESA	https://www.syri.net/kronike/918028/vrasja-ne-itali-shqiptari-nuk-kishte-vjedhur-asgje-a-utori-ndihem-i-deshperuar/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 17:08:37 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	20 shtator 2026, 16:46:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	1fb9cb6bc2f504a7cc6db0b8e47643fdd3ef2c595f588af0d8dfdba48d2bce77
TEKSTI	c85480493736c0ff1669f9f9ed18ff7857fe9b5e63de2458bf7b4104ba9e644f
PAMJA	2b2a391251e97b9717fcb6eefab552f4ca29f8ac72e11ce9150fa928bdc3088c

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f08145fc009d9bceafac1c3fe311b1a1fcf16514f906abbed4eb872176ffc915
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	f7f0073ad38d84bc7b2018e08e1ed9b5f21036120699a0dce35325619714cf4d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/f08145fc009d9bceafac1c3fe311b1a1fcf16514f906abbed4eb872176ffc915>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**ENVER BYTYÇI**Vendimi i Hagës dhe raporti
ynë me të vërtetën!**ENVER ROBELLI**Qëndrimi i Zagrebit dhe
heshitja e Tiranës

më të lexuarat

Bllokimi i pagave të gjyqtarëve/ SPAK
merr në pyetje përgjegjësen e Thesarit, ja
çfarë dimë deri tani

Kurbin/ Banesa iu shemb nga tërmeti,
qytetari: Ende pa një afat për strehimin

Kapet mbi 400 kilogramë drogë në
frigorifer, arrestohet i riu shqiptar

DOSJA - Dy turistë nga Suedia vizitojnë
Tiranën, por pretendojnë se janë
përdhunuar nga 5 djem

Përfshihet nga flakët një makinë në një
parkim nëntokësor në Fier

Suk, fshati që po zbrazet: Kafenetë pa
klientë, vendin e tyre e kanë zënë pulat

Shortohet seanca në Froy's Asasin e



Vrasja në Itali, shqiptari nuk kishte vjedhur asgjë, autori: Ndihej i dëshpëruar

18:46, 20/09/2026

ZMADHO TEKSTIN

'Jam i dëshpëruar.' Kjo është deklarata e Roberto Mollo, 35-vjeçarit italian që gjatë natës qëlloi me armë një grup personash që kishte hyrë në pronën e tij në Baldissero d'Alba, në provincën e Cuneos.

Një prej personave të grupit, një 36-vjeçar me origjinë shqiptare, u godit nga plumbi dhe ndërroi jetë. Mollo, i cili punon si shofer kamioni, është aktualisht nën hetim në gjendje të lirë për vrasje.

Sipas rindërtimit paraprak të hetuesve, Mollo ndodhej në pjesën e banueshme të shtëpisë së familjes, e cila është në rikonstrukcion, kur dëgjoi zhurma gjatë natës. Ai mori pistoletën që e posedonte në mënyrë të ligjshme dhe doli për të kontrolluar situatën.

Përballë tij ndodhej një grup prej të paktën 4-5 personash. 35-vjeçari qëlloi disa herë në errësirë, duke goditur njërin prej tyre. Pjesëtarët e tjerë u larguan me shpejtësi nga vendi i ngjarjes.

Një nga detajet e rëndësishme të hetimit është se grupi nuk pati kohë të kryente grabitjen.

Në pronën që Mollo po rikonstruktonte kishte materiale ndërtimi, vegla pune dhe materiale të tjera të grumbulluara jashtë objektit. Sipas hetuesve, këto dyshohet se ishin objektivi i grupit.

Megjithatë, nga kontrolli i kryer pas ngjarjes nuk rezultoi të jetë marrë asnjë send. Grabitësit u larguan pa arritur të përfundonin vjedhjen.

Pas ngjarjes, Mollo ka përfunduar në qendër të hetimit të Prokurorisë së Astit. Ai ka deklaruar se është i dëshpëruar për atë që ndodhi.

Pistoleta ishte e regjistruar dhe mbahej në mënyrë të ligjshme, ndërsa autoritetet po verifikojnë rrethanat në të cilat ajo është përdorur në pronën që ishte në rikonstrukcion.

Pas të shtënave, vetë 35-vjeçari ka telefonuar karabinierët dhe shërbimet e emergjencës. Ekipet mjekësore tentuan të shpëtonin 36-vjeçarin, por ai nuk mundi të mbijetonte.

Ndërkohë, karabinierët po kërkojnë personat e tjerë të grupit, të cilët u larguan

nga zona. Hetuesit po verifikojnë gjithashtu nëse pas largimit në këmbë ata kanë përdorur një automjet.

Mollo, i cili më parë ka punuar si hidraulik, përshkruhet nga banorët e zonës si një person i qetë dhe i përkushtuar ndaj punës. Ai jeton me nënën e tij, rreth 200 metra larg banesës së familjes që po rikonstruktonte.

© SYRI.net

Lexo edhe:



Itali, sherr për motive dashurie në Kremona, 5 shqiptarë dhe një italian nën hetim



Po peshkonte me korent në lumin Drini i Zi, ndërron jetë 31-vjeçari në Dibër



VIDEO/ Digjet plotësisht 'Toyota' në aksin Gjirokastrë-Tepelenë

Uljan Shpatarakun- Ja kush gjyqtar e ka në dorë



Falsifikuan dokumentet për 6 prona, arrestohet ish-drejtori i ASHK në Fier, sekuestrohen 715 mijë euro



Shtyhet seanca ndaj Ilir Metës dhe Monika Kryemadhit, mungoi anëtar i trupit gjykues

TË NGJASHME



FOTO/ Vritet me armë shqiptari në Itali, gjatë një grabitjeje të dështuar



Flakët përfshijnë vendgrumbullimin e mbetjeve në Fushë-Krujë, përsëritet zjarri për të disatën herë



Zjarr në varrezat e Babicës/ Rrezikohet një banesë, digjen dhjetëra ullinj shekullorë



Kakavijë, policia greke ndalon një person me pasaportë të Kilit të vjedhur në Belgjikë



Vrasja e Artan Myrtaj/ Rikthehet në vëmendje e shkuara e errët e 'Danes', bashkëpunëtorit të 44-vjeçarit



Pamje ekskluzive/ VIDEO nga ajri i vrasjes 76 m larg policisë, oficerët mbidhnin gëzhojat në vendgjarje



EMRI/ Aksident në rrugën Fier-Seman, plagoset 27-vjeçarja

LAJME POLITIKE KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË-STIL TRASHËGIMI MIEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do të gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojme të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.